



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE E MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO ZA RAD I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WLFARE

TRUPI EKZEKUTIV I INSPEKTORIATIT TË PUNËS/Izvršno Telo Inspektorata Rada/Exekutive Bady of Labour

Inspectorate

01.Nr.06-131-1/2014

Inspektorët e Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale-T E i Inspektoratit të Punës, Violetë Nishori ID 2127 , Kosovare Kurdija ID 2126 dhe Ahmet Ahmeti ID 1029 ,të autorizuar me dispozitën e nenit 82,94 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, , nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr.2002/9 dhe Nr.03/ L-17 për Inspektoratin e Punës në Kosovë,më 29.10.2014, marrin këtë:

VENDIM

Kërkesa e Arsim Halili e protokoluar me 01 Nr.06-131-1/2014 më datën 10.10.2014, **është e bazuar**, sepse janë konstatuar shkelje të dispozitave të nenit 85 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 14 paragrafi 14.2 të Rregullores për Përgjegjësit Materiale dhe Disiplinore , nenit 18 paragrafi 18.2 , nenit 19 paragrafi 19.1 dhe nenit 21 të Rregullores për Përgjegjësit Materiale dhe Disiplinore.

Obligohet Punëdhënësi(Radio Televizioni i Kosovës) që në afat prej 8 ditëve të shfuqizoj Vendimin nr.2179/14 të dt.18.07.2014.

Pas kalimit të afatit prej 8 ditëve , në afatin vijues prej 3 ditëve ,të informohet me shkrim Inspektorati i Punës për eliminimin e parregullësive në fjalë. Në të kundërtën do të konsiderohet se parregullësit nuk janë eliminuar.

Në bazë të nenit 6.4 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, ankesa e ushtruar në Vendimin e Inspektorit të Punës, nuk e shtynë ekzekutimin.

Arsyetim

Inspektoratit të Punës në Prishtinë i është drejtuar kërkuesi Arsim Halili, me kërkesën e protokoluar me 01 Nr.06-131/2014 më datën 10.10.2014.

Kërkuesi, në kërkesën e tij ka theksuar: se në rastin e tij janë shkelur të drejtat e garantuara me ligjin e punës, është përdorë qasje selektive, diskriminuese lidhur me shqiptimin e masës disiplinore vërejtje e fundit me shkrim, nga ana e Komisionit Disiplinor të RTK-së.

I ka propozuar Inspektoratit të Punës që të ndërmerr veprime juridike në kuadër të kompetencave, për mbrojtjen e të drejtave të tij.

Me raportin zyrtar të inspektimit nr. 01.Nr.06-131/2014 është konstatuar kjo gjendje faktike:

Komisioni disiplinor në RTK më datën 11.07.2014 ka mbajtur shqyrtimin disiplinor për shkeljet e supozuara të detyrave të punës konkretisht për shkak të mos vijueshmërisë së rregullt të orarit të plotë të punës ndaj të punësuarit Arsim Halili, Komisioni në fjalë ka konstatuar shkelje të rëndë të detyrave të punës konkretisht të nenit 6.1 nënparagrafi y i cili thotë se qëllimisht falsifikon dokumente apo shënime që kanë të bëjnë me detyrën e tij apo saj, të nenit 6.1 nënparagrafi k dhe x, andaj të punësuarit Arsim Halili i shqiptohet masa disiplinore-vërejtje e fundit me shkrim.

Në procesverbalin pa numër të dt.11.07.2014 në shqyrtimit disiplinor kanë qenë prezent: Liridon Cahani-kryetar, Naser Gjinovci -antarë, Amra Zeneli-antarë, Rilind Gërvalla-përfaqësues nga sindikata SPRTK dhe Arsim Haliti- përfaqësues nga sindikata SPERTK(nuk ka qenë prezent).

Procesverbali nuk është i nënshkruar as nga procesmbajtësja Gëzime Gashi dhe as nga antarët e komisionit disiplinor ose nga kryetari i komisionit.

Bazuar nga shkresat e lëndës rezulton se punonjësi Arsim Halili nuk është ftuar për pjesëmarrje në seancën disiplinore të datës 11.07.2014.

Komisioni Disiplinor bazuar në deklaratat me shkrim të: Ngadhnjim Kastrati- redaktor përgjegjës i lajmeve, deklaratën/propozimin për shkelje disiplinore nga Lorik Arifaj u.d. Kryeredaktor në RTK-TV, kopjet e vijueshmërisë në punë për të punësuarin Arsim Halili dt.22.05.2014,20.05.2014, 19.05.2014, 15.05.2014, 14.05.2014 dhe 13.05.2014, deklarata me shkrim nga Fitim Selmani-shef i mbrojtjes dhe shpëtimit, renditja e lajmeve e edicioneve të orës 10:00 dhe 11:00, raport i evidences në punë për të punësuarin Arsim Halili nga muaji Janar 2014- Qershor 2014 merr vendim ku të punësuarit Arsim Halili për shkelje të rënda të detyrave të punës i shqiptohet masa disiplinore –Vërejtje e fundit me shkrim duke u bazuar në nenin nenit 6.1 nënparagrafi y.

Vendimi Nr.2179/14 dt. 18.07.2014 për shqiptimin e masës në fjalë është i nënshkruar nga kryetari i komisionit disiplinor Liridon Cahani, antarë Amra Zeneli por jo edhe nga anëtari tjetër Naser Gjinovci, për të cilin është nënshkruar dikush tjetër.

Vendimi në fjalë, bazuar në shkresën pranim/dorëzim i është dorëzuar të punësuarit më 29.08.2014, ora 12:02.

Punonjësi Arsim Halili ka ushtruar ankesë (ankesa me nr.2667/14 dt.11.09.2014) kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje e fundit me shkrim tek organi kompetent i punëdhënësit. Me rastin e inspektimit u konstatua që punëdhënësi në fjalë nuk ka vendosur sipas ankesës së ankuesit bazuar në nenin 78 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe nenit 21 të Rregullores për Përgjegjësit Materiale dhe Disiplinore.

Andaj bazuar në këtë që u tha më lartë dhe me rastin e inspektimit , janë konstatuar shkelje të dispozitave të nenit 85 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 14 paragrafi 14.2 të Rregullores për Përgjegjësit Materiale dhe Disiplinore , nenit 18 paragrafi 18.2 , nenit 19 paragrafi 19.1 dhe nenit 21 të Rregullores për Përgjegjësit Materiale dhe Disiplinore. Po ashtu Rregullorja për Përgjegjësit Materiale dhe Disiplinor nuk është në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës e obligueshme me nenit 95 të këtij Ligji.

Në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky Vendim është përpiluar në ekzemplarë të nevojshëm. Nga një ekzemplar i dorëzohet: paraqitësit të kërkesës dhe "Radio Televizionit të Kosovës" ndërsa ekzemplarët tjerë ,Inspektorët e Punës i mbajnë për procedurë të mëtejme.



Inspektorët e Punës
 Violetë Nishori _____
 Kosovare Kurdija _____
 Ahmet Ahmeti _____

Udhëzim juridik: kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 8 ditësh T E të Inspektoratit të Punës në Kosovë , nëpërmes Inspektorëve të Punës në Prishtinë, Rruga e "UÇK " –"Qafa" Lamela II/2, Nr. 58.